



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE  
NGRITJE NË DETYRË DHE PRANIM NGA JASHTË  
SHËRBIMIT CIVIL  
NË KATEGORINË E MESME DREJTUESE**

**Lloji i diplomës " Shkenca Ekonomike ", niveli minimal i diplomës "Master Shkencor".**

Në zbatim të Nenit 26, të Ligjit 152/2013 "Për Nëpunësin Civil" i ndryshuar, si dhe të Kreut II, dhe III, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 242, datë 18/03/2015, "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", Institucioni I Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi shpall Procedurat e Lëvizjes Paralele, Ngritjes në Detyrë dhe Pranim nga Jashtë në Shërbimin civil, në pozicionin:

**1. Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse – Kategoria e pages: II-b**

*Pozicioni i më sipërmë, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil.*

**PËR TË TRE PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË  
DETYRË DHE PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL )  
APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për:**

**LËVIZJE PARALELE**

**21/07/2019**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për:**

**NGRITJE NË DETYRË DHE PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL**

**26/07/2019**

## **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:**

- Ndjek punën për zbatimin e të gjitha procedurave të pranimeve dhe emërimeve në shërbimin civil, transferimet dhe largimet nga puna si dhe trajtimin e personelit, sipas kërkesave të ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, të rregullores së brendshme të institucionit dhe urdhërave dhe udhëzimeve të Komisionerit.
- Kërkon zbatimin e detyrave nga personeli që ka në varësi.
- Harton raporte lidhur me organikën dhe treguesit e tjerë që kërkohen nga Komisioneri apo institucione të tjera.
- Organizon punën për ngritjen e komisioneve të prokurimeve dhe blerjeve të materialeve të nevojshme për Zyrën e Komisionerit sipas kërkesave të akteve ligjore e nënligjore.
- Mban lidhje të drejtëpërdrejta me Komisionerin, duke bashkërenduar punën me të gjitha strukturat e tjera, për hartimin dhe zbatimin e planit ekonomik e financiar.
- Drejton punën për njohjen e gjendjes financiare dhe për përmbushjen e procedurave të përpilimit të kërkesave buxhetore të Zyrës së Komisionerit.
- Udhëheq punën për planifikimin, sigurimin dhe zbatimin e buxhetit të miratuar për realizimin e fondeve financiare dhe të investimeve në fushën e veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit.
- Harton programe tre mujore të kontrollit, si dhe programin vjetor të ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar.
- Ndjek paraqitjen në punë të personelit të administratës dhe i paraqet në çdo fund muaji degës së financës listë prezencën për përpilimin e listë pagesës dhe bashkëpunon me specialistin e burimeve njerëzore për zëvendësimin e punonjësve që mungojnë.
- Ndjek dhe koordinon punën me specialistin e burimeve njerëzore për planifikimin, evidentimin dhe zbatueshmërinë e lejeve vjetore të punonjësve të Zyrës së Komisionerit.
- Ndjek procedurat e specializimeve apo kualifikimeve të punonjësve të Zyrës së Komisionerit brenda dhe jashtë vendit.
- Përgjigjet për masat e marra në raste ceremoniale, për paisjet e nevojshme, rregullimet e mjediseve të caktuara, dekoracionet e duhura.
- Realizimin i detyrave në rolin e autoritetit përgjegjës për ILDKPKI në zbatim të ligjit Nr.9367, datë 07.04.2005 “ Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
- Ndjek dhe koordinon punën me specialistin e Arkiv-Protokollit për regjistrimin e korrespondencës së institucionit dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar të institucionit dhe krijimin e regjistrave dhe inventarëve të dosjeve, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre dhe gjithë dokumentacionit sipas ligjit “Për Arkivat”

## LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

### 1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

#### **Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

- a- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar brenda së njëjtës kategori (kategoria II-b);
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

#### **Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor " në Shkenca Ekonomike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;  
*(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b- Të kenë të paktën 5 vitë përvojë pune në profesion, nga të cilat 3 vite në nivel/ pozicion drejtues. Preferohet të ketë përvojë pune në menaxhimin ekonomik – financiar të projekteve.
- c- Të ketë njohuri të gjuhës angleze ose të një gjuhe kryesore të BE-së ( frengjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht).
- d- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup

## **1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

### **Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

*<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>*

b - Fotokopje të diplomës ose diplomave të studimeve universitare. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;

c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

g - Vlerësimin e fundit të punës;

h- Aktin e fundit të emërimit në pozicionin aktual, në të cilin të përcaktohet edhe kategoria e pozicionit, ose në pamundësi një vërtetim nga institucioni lidhur me pozicionin aktual të kandidatit dhe kategorinë përkatëse.

i - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

j - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

**Kandidati duhet të dorëzoje me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, pranë Protokoll/Arshivës (Rruga Durrësit Nr. 27, (ish Ministria e Mjedisit), Tiranë Tel:+355 4 2431078 Fax: +355 4 2431077 .e- mail: [www.info@kmd.al](mailto:www.info@kmd.al) dokumentat e sipërpërmendur):**

**Dokumentat për procedurën e lëvizjes paralele duhet të dorëzohen me postë ose drejtpërdrejt brenda datës: 21/07/2019**

## **1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **23/07/2019**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në stendën e informimit të publikut dhe në faqen zyrtare të KMD-së, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

**Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi";
- Ligjin nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", *i ndryshuar*.
- Ligjin nr.9131, date 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike; Ligjin nr.214/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë".
- Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
- Ligjin nr. 7961, date 12.07.1995 " Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", *i ndryshuar*
- Ligjin nr. 9367, date 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", *i ndryshuar*.
- Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".
- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", *i ndryshuar*;
- Ligjin nr. 9920, date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", *i ndryshuar*;
- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", *i ndryshuar*

**1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE****Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike "www.dap.gov.al"

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

## **1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të internetit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi( [www.kmd.al](http://www.kmd.al)), në stendën e informimit në KMD-së dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”

## **2 NGRITJA NË DETYRË**

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategorie më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin vakant.

### **2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA**

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:**

- a- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar në kategorinë III-a, III-a/1;
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga Institucioni)
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Shkenca Ekonomike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;

*(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*

b- Të kenë të paktën 5 vitë përvojë pune në profesion, nga të cilat 3 vite në nivel/ pozicion drejtues. Preferohet të ketë përvojë pune në menaxhimin ekonomik – financiar të projekteve.

c- Të ketë njohuri të gjuhës angleze ose të një gjuhe kryesore të BE-së (frengjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht).

d- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup

## **2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

### **Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:  
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- b - Fotokopje të diplomës ose diplomave të studimeve universitare. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Vlerësimin e fundit të punës;
  
- h- Aktin e fundit të emërimit në pozicionin aktual, në të cilin të përcaktohet edhe kategoria e pozicionit, ose në pamundësi një vërtetim nga institucioni lidhur me pozicionin aktual të kandidatit dhe kategorinë përkatëse.
- i - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- j - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

**Kandidati duhet të dorëzojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, pranë Protokoll/Arshivës (Rruga Durrësit Nr. 27, (ish Ministria e Mjedisit), Tiranë  
**Tel:+355 4 2431078 Fax: +355 4 2431077 .e- mail: [www.info@kmd.al](mailto:www.info@kmd.al)**  
dokumentat e sipërpërmendur):**

**Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e ngritjes në detyrë duhet të bëhet brenda datës: 26/07/2019**

## **2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **05/08/2019**, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga njësia e burime njerëzore të KMD-së, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

**Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi";
- Ligjin nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", *i ndryshuar*.
- Ligjin nr.9131, date 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike; Ligjin nr.214/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
- Ligjin nr. 7961, date 12.07.1995 " Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", *i ndryshuar*
- Ligjin nr. 9367, date 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", *i ndryshuar*.
- Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 “ Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.
- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, *i ndryshuar*;
- Ligjin nr. 9920, date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, *i ndryshuar*;
- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, *i ndryshuar*

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- a - Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b - Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c - Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “[www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al)”

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>



Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, do të marrin informacion në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure.

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi .

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

**3.1****KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL**

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:**

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor " në Shkenca Ekonomike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;

*(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*

- b- Të kenë të paktën 5 vitë përvojë pune në profesion. Preferohet të ketë përvojë pune në menaxhimin ekonomik – financiar të projekteve.

- c- Të ketë njohuri të gjuhës angleze ose të një gjuhe kryesore të BE-së ( frengjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht).

- d- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

## **3.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

### **Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:  
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- b - Fotokopje të diplomës ose diplomave të studimeve universitare. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- j - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

**Kandidati duhet të dorëzoje me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, pranë Protokoll/Arshivës (Rruga Durrësit Nr. 27, (ish Ministria e Mjedisit), Tiranë  
**Tel:+355 4 2431078 Fax: +355 4 2431077 .e- mail: [www.info@kmd.al](mailto:www.info@kmd.al)**  
dokumentat e sipërpërmendur):**

**Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e pranimit nga jashtë shërbimit civil duhet të bëhet brenda datës: 26/07/2019**

## **3.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **05/08/2019**, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga nga njësia e burimeve njerëzore të KMD-së, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

**Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi";
- Ligjin nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", *i ndryshuar* .
- Ligjin nr.9131, date 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike; Ligjin nr.214/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit " .
- Ligjin nr. 7961, date 12.07.1995 " Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", *i ndryshuar*
- Ligjin nr. 9367, date 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", *i ndryshuar*.
- Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 “ Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.
- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, *i ndryshuar*;
- Ligjin nr. 9920, date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, *i ndryshuar*;
- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, *i ndryshuar*

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- a - Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b - Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c - Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “[www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al)”

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimi në shërbimin civil për kategorinë e mesme drejtuese, do të marrin informacion në faqen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimi në shërbimin civil të kategorisë e mesme drejtuese

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” .

## **Njësia Përgjegjëse**